



# **MEMORANDUM BASHKEPUNIMI**

## **MIDIS**

## **UMSH & QKEV**

### **Neni 1**

Urdhri i Mjekëve të Shqipërisë (në vazhdim UMSH) dhe Qendra Kombëtare e Edukimit në Vazhdim (në vazhdim QKEV) në bazë dhe në zbatim të Ligjit Nr. 8615 datë 1.6.2000 “Për Urdhrin e Mjekëve në Republikën e Shqipërisë”; Ligjit Nr.10171 datë 22.10.2009 “Për Profesionet e Rregulluara në Republikën e Shqipërisë”, Ligjit Nr. Nr. 10107 datë 30.03.2009 “Për kujdesin shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, VKM nr 825 datë.14.05.2008 “ Për krijimin dhe funksionimin e Qendrës Kombëtare të Edukimit në Vazhdim të punonjësve të shëndetësisë”, dhe urdhrin ë Ministrit të Shëndetësisë Nr.554 datë 22.10.2009 për miratimin e Dokumentit Rregulator për Ricertifikimin e Profesionistëve të Shëndetësisë, shprehin vullnetin dhe mirekuptimin për të institucionalizuar bashkëpunimin e qëndrueshëm sipas fushave përkatëse, duke e konsideruar këtë bashkëpunim si angazhim dhe detyrim për zhvillimin e Edukimit Mjekësor të Vazhdueshëm, me qëllim rritjen dhe ruajtjen e qëndrueshme të standardeve më të larta profesionale të mjekëve.

### **Neni 2**

QKEV dhe UMSH e konsiderojnë të domosdoshme rritjen dhe përmirësimin e vazhdueshëm të kompetencës dhe performancës profesionale të mjekëve përmes formave të organizuara të Edukimit të Vazhdueshëm Mjekësor (EVM). Te dy

institucionet bien dakord të bashkëpunojnë për të nxitur dhe mbështetur këto forma në përputhje me nevojat dhe kërkesat profesionale të mjekëve. EVM shërben për të zhvilluar dhe rritur njohuritë dhe aftësitë shkencore të mjekëve në aspektin teorik, praktik dhe etiko-profesional në përputhje me zhvillimet dhe konceptet më të reja të shkencave mjekësore.

### **Neni 3**

Të dy institucionet bien dakord dhe angazhohen për të gjetur forma të zhvillimit më të gjërë programor në mënyrë që Edukimi Vazhdueshëm Mjekësor (EVM) të plotësojë kriteret dhe të përshtatet në kuptimin më të gjërë të fjalës në Zhvillimin e Vazhdueshëm Profesional (ZHVP) të mjekëve.

### **Neni 4**

QKEV akrediton forma të ndryshme të EVM. QKEV koordinon regjistrin kombëtar të ricertifikimit të profesionisteve të shëndetësisë. UMSH bashkëpunon dhe mbështet QKEV për gjetjen e formave më efektive dhe më të mundëshme të EVM, për pjesëmarrjen e mjekëve në përputhje me kërkesat dhe nevojat konkrete të tyre, me profilet dhe vendet e ushtrimit të praktikës profesionale, duke i dhënë rëndësi të veçantë organizimit të formave të EVM brënda institucioneve shëndetësore.

### **Neni 5**

QKEV dhe UMSH bien dakord dhe mbështesin sistemin e krediteve të detyrueshme për mjekët dhe dentistët si parakusht për rilicensimin e mjekëve dhe ruajtjen e të drejtës për ushtrimin e profesionit.

### **Neni 6**

UMSH dhe QKEV reciprokisht do të informojnë njëra tjetrën për ecurinë e procesit të edukimit në vazhdim, pjesëmarrjen e mjekëve, problemet dhe mangësitë

që evidentohen në rrugë e sipër dhe bien dakord për format e përmirësimit të mangësive të evidencuara në mbështetje dhe bashkëpunim të ndërsjelltë midis dy institucioneve.

### **Neni 7**

QKEV merr angazhimin për të njojur periodikisht UMSH me kreditet e arritura nga mjekët e dentistët e sektorit publik e privat, ndërsa UMSH në vartësi të këtyre rezultateve bën riliçensimin e tyre çdo 5 vjet.

### **Neni 8**

UMSH dhe QKEV marrin angazhimin e përbashkët për të transferuar frymen e mirëkuptimit dhe të bashkëpunimit që mbart nënshshkrimi i këtij Memorandumi në të gjitha strukturat e tyre qëndrore dhe lokale.

Për **UMSH**

Dr. Din ABAZAJ  
President

Për **QKEV**

Dr. Entela SHEHU  
Drejtore

This document was created with Win2PDF available at <http://www.win2pdf.com>.  
The unregistered version of Win2PDF is for evaluation or non-commercial use only.  
This page will not be added after purchasing Win2PDF.